



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
ZYRA E ADMINISTRIMIT TË PARKUT KOMBËTAR "LUMI I VJOSËS"

**SHPALLJE PËR POZICIONIN SPECIALIST NË SEKTORIN E MONITORIMIT NË
ZYRËN E ADMINISTRIMIT TË PARKUT KOMBËTAR "LUMI I VJOSËS"**

Në mbështetje të VKM-së nr.774, datë 13.12.2024 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës" (ZAPK Vjosa), institucion në nivel rajonal (Gjirokastrë), në varësi të ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura mjedisore, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.19, datë 3.2.2025 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës", si dhe të Urdhrit të Drejtorit të ZAPK "Për ngritjen e Komisionit Ad Hoc", nr.26, më datë 26.11.2025, shpallet pozicioni vakant i punës:

**SPECIALIST NË SEKTORIN E MONITORIMIT NË ZYRËN E ADMINISTRIMIT TË
PARKUT KOMBËTAR "LUMI I VJOSËS"**

**Afati për dorëzimin e dokumenteve 17/12/2025 pranë Zyrës së Administrimit të Parkut
Kombëtar "Lumi i Vjosës"**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Mbikëqyrja e efekteve mjedisore të çdo ndërhyrjeje apo zhvillimi të propozuar, brenda territorit gjeografik të Parkut Kombëtar.
- Monitorimi i zbatimit të planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës".
- Koordinimi dhe monitorimi i zbatimit të projekteve në Parkun Kombëtar "Lumi i Vjosës".
- Koordinimi i projekteve për menaxhimin e Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës" nga pikëpamja teknike, të financuara nga buxheti i shtetit apo burime të tjera financiare kombëtare dhe ndërkombëtare, për të siguruar respektimin e rregullave dhe procedurave teknike.
- Mbajtja e lidhjeve të vazhdueshme dhe informimi i strukturave të qeverisjes qendrore dhe vendore për zhvillimet e karaktereve të ndryshme dhe kërcënimet që kryhen jashtë territorit të Parkut Kombëtar, por që mund të kenë impakt në të.
- Kryerja e çdo detyre tjetër të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Raportimi dhe zbatimi i detyrave për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonave të mbrojtura mjedisore, që ndodhen brenda Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës".
- Monitorimi i zbatimit të standardeve të Parkut Kombëtar për përmbushjen e Standardit të Listës së Gjellbër të IUCN.
- Përgatitja dhe zbatimi i protokolleve të monitorimit dhe mirëmbajtja e bazave të të dhënave.

- Koordinimi i mbledhjes së të dhënave në terren dhe të dhënave dytësore në lidhje me speciet, habitatet, cilësinë e ujit, përdorimin e tokës, shërbimet e ekosistemit, ndikimet e vizitorëve, në bashkëpunim me “Rojet e Mjedisit”, kërkuesit shkencorë dhe partnerë të tjerë në aktivitetet monitoruese.
- Sigurimi i analizave të komponentëve të përzgjedhur të biodiversitetit dhe tendencave dhe kërcënimeve të tyre, të paraqitura në formën e raporteve të monitorimit për aplikim në sektorin e menaxhimit (përgatitja e planeve vjetore të punës, aktivitetet e ruajtjes dhe menaxhimi adaptiv).

KUSHTET PËR PRANIM DHE KRITERET E VEÇANTA për pozicionin Specialist në Sektorin e Monitorimit

Kandidatët për pozicionin “Specialist” duhet të plotësojnë kushtet për pranim si dhe kriteret e veçanta si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë minimalisht Diplomë Bachelor, Arsim i Lartë
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.
- Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritetet dhe respektuar afatet;
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;
- Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Jetëshkrim i aplikantit;
 - Fotokopje të diplomës/diplomave dhe listës së notave e noterizuar;
 - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - Vërtetim të gjendjes shëndetësore (në momentin e fillimit të marrëdhënieve të punës);
 - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 - Dy referenca nga punëdhënësi apo bashkëpunëtorë të mëparshëm;
 - Certifikata për trajnime në lidhje me pozicionin për të cilin konkurrojnë;
 - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në protokollin e Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”, brenda datës 17/12/2025.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Komisioni Ad-Hoc do të njoftojë kandidatët e kualifikuar për zhvillimin e intervistës së strukturuar me gojë, brenda datës 19.12.2025.
Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e mos kualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të intervistohen për njohuritë mbi dokumentet e listuara më poshtë:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10431, datë 9.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore";
- Njohuri mbi Vendimin nr.774, datë 13.12.2024 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës (ZAPK Vjosa).

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen edhe në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me fushën e njohurive (pjesë e kësaj shpalljeje), si dhe kompetencën mbi organizimin dhe menaxhimin e veprimtarisë drejtuese;
- b- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE KOMUNIKIMI

Kandidatët do të vlerësohen me pikë si më poshtë:

- a- Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 60 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 40 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, njësia përgjegjëse në ZAPK Vjosa do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesit në faqen zyrtare të ministrisë.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentacioneve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës 17.12.2025 në protokollin e ZAPK Vjosa;

Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datën 19.12.2025, në ambientet e Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës".

DREJTOR ZAPK VJOSA

